



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.55/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ramush Bardiqi - kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hidajete Gashi Alaj anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, parashtruar kundër Lista Serbe me seli në Komunën e Mitrovicës së Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më datë 28 Dhjetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 30.12.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.55/2025, e datës 28.12.2025, parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lista Serbe me seli në Komunën e Mitrovicës së Veriut, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Më datë 28.12.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me të cilën pretendohet se po atë ditë rreth orës 10:00, në ditën e heshtjes zgjedhore të Zgjedhjeve Parlamentare për Kuvendin e Republikës së Kosovës, aktivistët e LVV-së, në Mitrovicë kanë vërejtur se zyrtarët e subjektit politik Lista Serbe, në qendrën e qytetit të Komunës së Mitrovicës së Veriut, janë mbledhur para selisë së këtij subjekti politik ne sheshin “Car Llazar”, duke shkelur kështu nenin 37, paragrafi 1 ika 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Kanë kërkuar nga PZAP që ta pranojë ankesën si të bazuar dhe subjektit politik Lista Serbe ti shqiptohet masa e sanksionit të caktuar. Ankesës i kanë bashkëngjitur video.

Në përgjigje në ankesë Subjekti Politik Lista Serbe, sqarojnë se asnjë nga përfaqësuesit në ditën e zgjedhjeve nuk ka kryer ndonjë fushatë, as ka mbajtur ndonjë takim, madje kjo shihet qartë edhe në incizimin e dorëzuar. Për më tepër, nuk ekziston asnjë dëshmi në të cilët duket se ndonjë nga funksionarët u është drejtuar atëherë qytetarëve ose ka kryer ndonjë fushatë atë ditë, në përputhje me ligjin. Po ashtu, ankuesi në ankesën e tij nuk ka cituar asnjë dëshmi që

subjekti ynë politik të ketë organizuar publikisht ose në ndonjë mënyrë tjetër fushatë dhe grumbullim qytetarësh ose organizim të ndonjë mbledhjeje gjatë ditës së zgjedhjeve. Rasti ka të bëjë me një akuzim arbitrar të pabazuar ndaj këtij subjekti, pa ndonjë dëshmi për akuzime kaq të rrezikshme dhe të rënda, me të cilat shkatërrohet reputacioni i subjektit dhe anëtareve të tij. Kanë kërkuar nga PZAP që ta refuzojë ankesën e parashtruar si të pabazuar.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi pretendimet ankimore si dhe përgjigjen në ankese, gjeti se:

-Ankesa është e pa bazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, dhe përgjigjes në ankese të paraqitur nga Subjekti Politik Lista Serbe, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik LVV, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankese nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 37 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se *“Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.2 “ bërja e fushatës në çfarëdo mënyre”*. Kjo për faktin se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së nenit 37 par.1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës nr.08/L-228, mirëpo paneli vlerësoj se në bazë të videos së bashkangjitur në ankese nuk mund të vërtetohet se subjekti politik Lista Serbe ka bërë fushatë zgjedhore, apo ndonjë tubim.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës ku përcaktohet se *“vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankese nga parashtruesi i ankesës nuk paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.55/2025 më datën 30.12.2025

Kryesues i Panelit,
Ramush Bardiqi



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovës, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.